



Buletin informativ

Korrik 2021



Ekspertët fiskal në Mazars, sjellin pranë jush buletin informativ të rradhës si një përmbledhje e ndryshimeve/ shtesave ligjore dhe lajmërimeve zyrtare të publikuara në vendin tone gjatë muajit të fundit.

NDRYSHIMET LIGJORE

❖ Mosaplikim i gjobave për procesin e fiskalizimit

Dënimet administrative të parashikuara në kuadër të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” dhe të detajuara në Buletin Informativ Nr. 2 të Mazars, nuk do të aplikohen deri në datën 31 dhjetor 2021.

Theksojmë se shtyrja e afatit deri në datën e sipërpërmendur, lidhet vetëm me mosaplikimin e gjobave dhe jo me afatet e implementimit të procesit të fiskalizimit.

Burimi: Fletore Zyrtare nr. 106, datë 02.07.2021, Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 1.7.2021 “Për një shtesë në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

❖ Rimbursimi i TVSH-së për eksportuesit

Tatimpaguesit, për të cilët vlera e eksporteve zë 50% – 70% të vlerës së shitjeve, do të rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, pavarësisht nëse procesi i kontrollit tatimor ka përfunduar.

Kriteret për eksportuesit me risk zero janë ri-specifikuar si më poshtë:

- a) kanë status të aktivitetit “aktiv”;



Buletin informativ

- b) vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, e verifikuar edhe nga raportet doganore të eksporteve në sistem;
- c) kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;
- d) nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor.

Përpara këtij ndryshimi, eksportuesit do të duhej të paraqisnin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë.

Burimi: Fletore zyrtare nr.111, datë 14/07/2021. Vendim Nr. 418, datë 8.7.2021 "Për Një Ndryshim në Vendimin Nr. 953, datë 29.12.2014, Të Këshillit të Ministrave, Për Dispozitat Zbatuese Të Ligjit Nr. 92/2014, 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën E Shqipërisë", të ndryshuar".

❖ Hyn në fuqi marrëveshja ndërkombëtare me Mbretërinë e Arabisë Sauditë

Ratifikohet marrëveshja e nënshkruar mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Marrëveshja është efektive që nga data 1 dhjetor 2019, sipas dhe publikimit zyrtar në faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Burimi: Fletore zyrtare nr.84, datë 02/06/2021. Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6489, datë 31.5.2021 "Mbi Hyrjen në Fuqi të një Marrëveshjeje Ndërkombëtare".

NJOFTIME

❖ Përdorimi i dokumentacionit tatimor

Shtyhet afati i përdorimit të dokumentacionit tatimor ekzistues deri në datën 31 gusht 2021. Më parë lejohej përdorimi i blloqeve tatimore deri në fillimin e procesit të fiskalizimit sipas datave të përcaktuara për çdo kategori.

Ndërkohë, tatimpaguesit mund të tërheqin blloqet tatimore pranë drejtorive rajonale tatimore ku janë të regjistruar deri në datën 15 gusht 2021.

Burimi: tatime.gov.al/d/8/45/0/1630/njoftim-ne-lidhje-me-perdorimin-e-dokumentacionit-tatimor

❖ Mbi procedurën e fiskalizimit të deklaratave të importit

Tatimpaguesit janë të detyruar të fiskalizojnë faturën e importit jo më vonë se 3 ditë nga momenti që mallrat vendosen nën procedurën e qarkullimit të lirë nga Autoriteti Doganor.

Kjo procedurë zhvillohet si më poshtë:



Buletin informativ

- 1) Pasi mallrat vijnë në kufi dhe kryhet procedura e zhdoganimit, autoriteti doganor lëshon deklaratën doganore, dhe dërgon të dhënat nga deklaratat doganore në sistemin e informacionit të Administratës Tatimore.
- 2) Disa nga të dhënat e deklaratës doganore, (të specifikuar në Udhëzim) do të transferohen në Platformën Qendrore të Faturave.
- 3) Tatimpaguesi importues do të duhet të fiskalizojë faturat për mallrat e importuara në llogarinë e tij të përdoruesit në portalin Self-Care.

Burimi: tatime.gov.al/d/8/45/0/1632/njoftim-mbi-proceduren-e-fiskalizimit-te-deklaratave-te-importit

❖ Njoftim për detyrimin ligjor të raportimit të llogarive bankare

Bazuar në ligjin Nr. 154/2020 “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, lajmërohen tatimpaguesit që është ngritur edhe regjistri mbartës i të dhënave, ku subjekte raportuese janë të gjitha institucionet financiare banka dhe jo banka, të cilat kanë në administrimin e tyre llogari bankare dhe kasetat sigurie.

Mos-raportimi i informacionit të kërkuar është objekt penalitetesh sipas parashikimeve të këtij ligji.

Burimi: tatime.gov.al/d/8/45/0/1629/njoftim-per-detyrimin-ligjor-te-raportimit-te-llogarive-bankare

❖ Njoftim për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike

Bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe subjekte të tjera, të cilat ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë, do të duhet të regjistrojnë dhe të informojnë Administratën Tatimore për çdo pagesë të kryer gjatë çdo dite pune, në emër dhe për llogari të klientëve të tyre. Kjo procedurë do të duhet të ndiqet për transaksionet pa para në dorë midis dy tatimpaguesve dhe tatimpaguesve dhe organeve publike.

Njoftimi do të bëhet me mjete elektronike, përmes lidhjes në internet me sistemin e informacionit të Administratës Tatimore, deri në fund të çdo dite pune.

Burimi: tatime.gov.al/d/8/45/0/1626/njoftim-per-institucionet-financiare-jobankare

RIKUJTESË

❖ Dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore në QKB

Rikujtojmë të gjitha subjektet se data 31 korrik 2021 është afati final për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit pranë QKB për subjektet që e kanë të detyruar mbajtjen e tyre.

Në rast mosdorëzimi të dokumentave aplikohet sanksion administrativ gjorbë, prej 15 000 lekë.

Burimi: Fletore zyrtare nr.32, datë 09.03.2015, Ligj nr. 8/2015 datë 19.2.2015, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar



Buletin informativ

❖ Dorëzimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit

Rikujtojmë të gjitha shoqëritë tregtare se afati i fundit për dorëzimin e vendimi të organit përgjegjës për destinimin e fitimit pas tatimit është data 31 korrik 2021.

Vendimi duhet të ngarkohet elektronikisht në sistemin e-filing.

Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 lekë.

Burimi: tatime.gov.al/d/8/45/0/688/31-korrik-afati-i-fundit-per-dorezimin-e-vendimit-per-destinimin-e-fitimit-pas-tatimit

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutemi kontaktoni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889
E-mail: info@mazars.al